

PËR TË E KONTAKTUAR KOMITETIN E HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË:



Rr. Naum Naumovski Borce, Numër 83 në Shkup
Numrat e kontaktit: +38923119073 dhe +38972278436
E-mail: helkom@mhc.org.mk

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ofron ndihmë juridike parësore për qytetarët

Të drejtën në ndihmë primare juridike e ka çdo person fizik i cili ka vendbanim ose qëndrim në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sipas Ligjit për ndihmë juridike falas, të drejtë në ndihmë juridike dytësore/sekondare kanë viktimat e dhunës në familje dhe në bazë gjinore (pa përcaktuar gjendjen materiale të kërkuesit) dhe qytetarët me të ardhura të ulëta (me përcaktimin e gjendjes materiale të kërkuesit).

Me ndihmën juridike parësore merrni:

- ✔ Informacion të përgjithshëm ligjor;
- ✔ Këshillë të përgjithshme juridike;
- ✔ Ndihmë në plotësimin e formularëve;
- ✔ Ndihmë për plotësimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore/sekondare;
- ✔ Monitorim i procedurës së përgjithshme për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna në bazë gjinore, duke paraqitur kërkesa për informim në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në prokuroritë publike themelore dhe gjykatat kompetent;
- ✔ Paraqitje të kërkesave për inspektim të jashtëzakonshëm të qendrave të punës sociale nga sektori për Inspektim në fushën e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes të fëmijëve në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale.



Ministero degli Affari Esteri
e della Cooperazione Internazionale

Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë. Përmbajtja e botimit është përgjegjësi e vetme e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe nuk shpreh domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë.

JETË PA DHUNË

INFORMACION MBI AKSESIN NË NDIHMË
JURIDIKE PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË
FAMILJE DHE ME BAZË GJINORE



1. Në familjen dhe mjedisin ku jetoni apo punoni, vallë jeni përballur apo jeni dëshmitar i ndonjë prej llojeve të renditura të dhunës apo shqetësimeve?



Dhuna fizike

(çdo akt i ushtrimit të forcës fizike ose akt me të cilin dëmtohet shëndeti dhe integriteti fizik dhe mendor i viktimës)



Dhuna psikologjike

(çdo sjellje duke përdorur shtrëngim, frikësim ose kërcënim, që shkakton ndjenjën e frikës, kërcënimit, ankthit ose cenim të dinjitetit dhe integritetit psikologjik të viktimës)



Ngacmimi seksual

(çdo sjellje verbale, joverbale ose fizike e natyrës seksuale që ka për qëllim ose pasojë cenimin e dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtëruar ose fytes)



Dhuna ekonomike

(çdo akt kufizimi ose parandalimi në realizimin dhe/ose disponimin e të ardhurave personale dhe burimeve financiare, për të mbajtur familje e përbashkët dhe për kujdesin e fëmijës, që shkakton varësi ekonomike të viktimës)

2. Vallë jeni përballur me ndonjë formë dhune nga partneri martesor/jashtëmartesor apo ish-partneri?
3. Vallë jeni përballur me ndonjë formë të dhunës me bazë gjinore?
4. Vallë jeni fyer dhe kërcënuar në rrjetet sociale bazuar vetëm në përkatësinë juaj gjinore, statusin tuaj të dashurisë ose statusin jashtë/martesor?
5. Vallë institucionet sigurojnë mbështetje adekuate për viktimat e dhunës në familje dhe me bazë gjinore?
6. Vallë e keni denoncuar dhunën në stacion policor apo qendrën e punës sociale?
7. Vallë keni zhvilluar procedura gjyqësore për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore?

ÇFARË ËSHTË DHUNA NË FAMILJE DHE ME BAZË GJINORE?

DEFINICIONET:

1. **Dhuna ndaj grave** është shkelje e të drejtave të njeriut, diskriminim ndaj grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që çojnë ose ka gjasa, gratë të i çojnë në lëndime ose vuajtje fizike, seksuale, mendore ose ekonomike, duke përfshirë kërcënimet direkte dhe indirekte dhe frikësimet për veprime të tilla, zhvatja, kufizimi arbitrar dhe/ose privimi nga liria, pavarësisht nëse ato ndodhin në jetën publike ose private;
2. **Dhuna me bazë gjinore ndaj grave** është dhunë e drejtuar ndaj gruas sepse ajo është grua ose diçka që e prek atë në mënyrë disproporcionale. Dhuna me bazë gjinore ndaj grave i përfshin shkaqet dhe rezultatit nga marrëdhënie të pabarabarta të fuqisë ndërmjet grave dhe burrave si rezultat i një problemi shoqëror dhe jo individual. Dhuna me bazë gjinore ndaj grave i referohet edhe dhunës ndaj grave të përcaktuara në pikën 1 dhe 3;
3. **Dhuna në familje** është maltretim, fyerje, rrezikim i sigurisë, lëndim trupor, dhunë seksuale ose dhunë tjetër psikologjike, fizike ose ekonomike me të cilën shkaktohet ndjenjë e pasigurisë, kërcënim ose frikë, duke përfshirë kërcënime edhe për veprime të tilla, ndaj bashkëshortit, prindërve ose fëmijëve, ose personave të tjerë që jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose në familje të përbashkët, si edhe ndaj bashkëshortit aktual ose ish-bashkëshortit ose partnerit jashtëmartesor ose persona që kanë fëmijë të përbashkët, ose janë në një marrëdhënie të ngushtë personale, pavarësisht nëse kryesi e ndan ose e ndante të njëjtën banesë me viktimën, ose jo.
4. **Përndjekja** është çdo sjellje e qëllimshme kërcënuese e përsëritur e drejtuar ndaj një personi tjetër, që shkakton që personi të frikësohet për sigurinë e tij;
5. **Martesa e detyruar** është detyrimi, mashtrimi, sjellja në hutë, kërcënim ose, në mënyrë tjetër detyrim, i një të rrituri ose fëmije, për bashkim martesor ose jashtëmartesor;

ÇFARË MUND TË BËSH NËSE NDIEN SE JE VIKTIMË E DHUNES NË FAMILJE, DHUNËS ME BAZË GJINORE APO SHQETËSIMIT?



T'I DREJTOHESH QENDRAVE DHE KËSHILLIMOREVE PËR GRA - VIKTIMA TË DHUNËS NË FAMILJE DHE ME BAZË GJINORE.

Rajoni i Shkupit - Qendër dhe e Këshillimore për gratë viktimë të dhunës me bazë gjinore/dhunë në familje

Kontakt: JU Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale Shkup +38978230943; +38976381762; jumcsrSkopje@mtsp.gov.mk

Ekip i specializuar për trajtimin e rasteve urgjente të kategorive vulnerabël

Kontakt:+38976381762; +38978230943

Rajoni i Pollogut - Tetovë - Qendra këshillimore për punën me gratë viktimë të dhunës me bazë gjinore/dhunë në familje

Kontakt: JU Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale Tetovë +38978837111; jumcsrTetovo@mtsp.gov.mk

Rajoni i Vardarit - Velesi - Qendra për gratë viktimë të dhunës me bazë gjinore/ dhunë në familje

Kontakt: JU Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale Veles +38970362281; jumcsrVeles@mtsp.gov.mk

Rajoni verilindor - Kumanovë - Qendra këshillimore për punë me gratë viktimë të dhunës me bazë gjinore/dhunë në familje

Kontakt: JU Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale Kumanovë +38975362881; jumcsrKumanovo@mtsp.gov.mk

Rajoni Jugperëndimor - Ohër - Qendra dhe Qendra e Këshillimit për gratë viktimë të dhunës me bazë gjinore/dhunë në familje

Kontakt: JU Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale Ohër +38972232076; +38970267831; +38971231032; jumcsrOhrid@mtsp.gov.mk

Rajoni lindor - Shtip - Qendra e këshillimit për gratë viktimë të dhunës me bazë gjinore/dhunë në familje dhe Qendra e Krizave për gratë viktimë 24/48.

Kontakt: JU Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale Shtip +38976475054; jumcsrShtip@mtsp.gov.mk

Kavadari - Qendra këshillimore për punë me gratë viktimë të dhunës me bazë gjinore/dhunë në familje

Kontakt: JU Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale Kavadar +38978298015; jumcsrKavadarci@mtsp.gov.mk

Rajoni i Pellagonisë - Prilepi - Qendra e këshillimit për gratë viktimë të dhunës me bazë gjinore/dhunë në familje dhe Qendra e Krizave për gratë viktimë 24/48.

Kontakt: JU Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale Prilep +38978289427; jumcsrPrilep@mtsp.gov.mk

Manastir - Qendër dhe Këshillimore për punën me gratë viktimë të dhunës me bazë gjinore/dhunë në familje

Kontakt: JU Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale Manastir +38971397112; jumcsrBitola@mtsp.gov.mk